



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Planuar / Doretuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	26.05.2022	2	viti god. year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM8HCK	3059/2022		1/3



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.376/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.376/2022 të datës 14.04.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë Rruga

kundër Vendimit me Nr. 1523-KOM të datës 16.03.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 26.05.2022, mori këtë:

### V E N D I M

**HEDHET** poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.376/2022 e datës 14.04.2022 e parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ankuesi sipas akt emërimit të datës 21.06.2019 është i sistemuar në vendin e punës "Zyrtar për të Hyra Financiare", në Agjencinë për Pronësi Industriale, i cili sipas Vendimit me numër Ref.Nr.01/37 të datës 28.07.2021 të marrë nga Ministria e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë është caktuar "Zv. Drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë e Pronësi Industriale" në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, i cili me datë 25.02.2022 nëpërmjet e-mail-it zyrtarë ka parashtruar kërkesën për fillimin e procedurës disiplinore ndaj zyrtarit

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë me datë 16.03.2022 merr vendimin me numër 1523-KOM me të cilin vendim nëpunësit civil i shqiptohet masa disiplinore "Ndalim në pagë 20% në periudhë prej gjashtë (6) muajve", ankuesi i pa kënaqur me vendimin e Komisionit Disiplinor me numër 1523-KOM të datës 16.03.2022 me datë 14.04.2022 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër të protokollit 2110/2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores



Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 22.04.2022 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Këshilli më datë 05.05.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:* Ankesën e ankuesit të datës 14.04.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 16.03.2022 të Komisionit Disiplinor; E-mail i datave 25.02.2022; 24.02.2022; 28.02.2022; 29.12.2021; 22.02.2022; 29.12.2021; 08.02.2022; 09.02.2022; 14.01.2022; 24.11.2021; 23.11.2021; 22.11.2021; 22.11.2021, 24.11.2021; 21.11.2021; 19.11.2021; 30.11.2021; Vendimi i datës 28.07.2021; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 05.05.2017; Akt emërimi i datës 21.06.2019; Vendimi i datës 20.08.2021; Vendimi i datës 25.11.2021; Procesverbali i datës 16.03.2022 i Komisionit Disiplinor; Procesverbali i datës 14.03.2022 i Komisionit Disiplinor; Procesverbali i datës 08.03.2022 i Komisionit Disiplinor; e-mail i datës 15.03.2022; 10.03.2022; 09.03.2022; Raporti javor i datës 06.09.2021; 23.08.2021, 04.10.2021; 13.09.2021; 13.09.2021; 22.11.2021; 15.11.2021; 19.11.2021; 22.02.2022; 20.12.2021; Kërkesa për verifikim të mallit e datës 16.11.2021; Ftesa e datës 24.08.2021; Përgjigje 24.08.2021; Aktvendimi i datës 04.11.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë; e-mail i datës 17.11.2021, 19.11.2021, 24.11.2021, 13.12.2021, 15.12.2021 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i shqyrtuar të gjitha provat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankuesit, *është e palejuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, ankuesi sipas akt emërimit të datës 21.06.2019 është i sistemuar në vendin e punës "Zyrtar për të Hyra Financiare", në Agjencinë për Pronësi Industriale, i cili sipas Vendimit me numër Ref.Nr.01/37 të datës 28.07.2021 të marrë nga Ministria e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë është caktuar "Zv. Drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë e Pronës Industriale" në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Ankuesi me datë 25.02.2022 ka parashtruar kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj nëpunësit për shkak të shkeljeve të rënda të përcaktuara sipas dispozitave ligjore të Ligjit për Zyrtarët Publik.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ka nxjerr Vendim me numër 1523-KOM të datës 16.03.2022 me të cilin vendim nëpunësit civil z i shqiptohet masa disiplinore "Ndalim në pagë 20% në periudhë prej gjashtë (6) muajve".

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër 1523-KOM të datës 16.03.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, pretendon që Komisioni Disiplinor në këtë rast ka dështuar që të përcaktoj saktë parimin e individualizimit të shkeljes së supozuar sipas nenit 45, 46 dhe 50 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe se masa disiplinore supozon se nuk është përcaktuar drejtë për shkeljen e rëndë të bërë të përcaktuar sipas nenit 47 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike, përcaktohet se: "Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim,



që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji. E drejta e ankimit në KPMSHC i njihet edhe çdo kandidati në një procedurë pranimit në Shërbimin Civil. Pas shterimit të drejtës së ankimit në KPMSHC, mund të iniciohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente për çështjet administrative”, ndërsa me nenin 124 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet legjitimimi, shkaqet dhe mjetet juridike administrative, ndërsa paragrafi 1 i këtij neni përcakton që: “Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim. Anëtari i një organi kolegjal, ka gjithashtu të drejtën të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi procedural të organit kolegjal, nëse pretendon se një nga dispozitat e neneve 37-43 të këtij Ligji janë shkelur nga një veprim apo mosveprim i tillë”, kështu që Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në këtë rast vlerëson se ankuesesit edhe si palë e tretë nuk i janë cenuar asnjë e drejtë nga marrëdhënia e tij e punës, rrjedhimisht nuk ka legjitimitet për parashtrim të ankesës kundër Vendimit me numër 1523-KOM të datës 16.03.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Bazuar në këtë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mund të parashtrorj në vetëm nëpunësit civil të cilëve i’u janë shkelur të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, kështu që meqenëse ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, të Kosovës nuk i plotëson kushtet për parashtrim të ankesës sipas nenit 124 paragrafi 1, nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, atëherë e njëjta konsiderohet se është pa pranueshme.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**SHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda A.nr.376/2022

Valentina Kaçandolli BEKTESHI

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Udhëheqësës së Personelit në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë si dhe
- Arkivit të KPMSHC- së.

